



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2069/2 prot.

Datë 25.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Horieti” P.F. në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-09408-06-13-2024, me objekt: “Blerje materiale te ndryshme per lysterje dhe sherbetime te objekteve arsimore ne bashki + njesi administrative per vitin shkollor 2023-2024”, me fond limit 3,303,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
- Ankimues:** “Bajro Bros” SHPK me NIPT M113130290 dhe adresë: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017 , Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Librazhd  
Sheshi : “Gjorg Golemi” , Librazhd.
- Subjekte të Interesuara:** “Gentian Horieti” P.F. me NIPT K31427013J dhe adresë: 5 MAJI ISH NPK, Tiranë.

Në datën 24.07.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4374, si dhe nr. protokollit 2069/2024 datë 24.07.2024, i operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-09408-06-13-2024, me objekt: “Blerje materiale te ndryshme per lysterje dhe sherbetime te objekteve arsimore ne bashki + njesi administrative per vitin shkollor 2023-2024”, me fond limit 3,303,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Horieti” P.F në procedurën e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”*.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se oferta e OE “Gentian Horieti” P.F është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO-ja përkatëse, duhet të zbatonte ndryshimet ligjore të datës 08.02.2024, nenin 27 të Ligjit 16/2024, në të cilin thuhet: *“Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”*.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 25.07.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**